



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT
TË INDUSTRIËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN
E MINIERAVE DHE INDUSTRIËS

Nr. 887/1 Prot.

Tiranë, më 16.02.2022

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.850/1, datë 28.03.2005.

SHOQËRISË “ALB-DONI” SH.P.K
Lagjia “Vullnetari”, Pallati 646, Elbasan.

Për dijëni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Bloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë.

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.

Shoqëria “ALB-DONI” sh.p.k, është zotëruese e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.805/1, datë 28.03.2005, për mineralin Gips, në objektin “Shkëmbi i Zekthit”, Bashkia Belsh, Qarku Elbasan.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr.464, datë 25.01.2022, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr.887, Prot, datë 27.01.2022, është propozuar revokimi i Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.805/1, datë 28.03.2005, për mineralin Gips, në objektin “Shkëmbi i Zekthit”, Bashkia Belsh, Qarku Elbasan pasi nuk ka respektuar kërkesat e legjislacionit minerar lidhur me pagesën e garancisë financiare të rehabilitimit për vitin 2021.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në Nenin 47, pika 1, gërma “ç” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen Minerare të Shfrytëzimit** Nr.805/1, datë 28.03.2005, për mineralin Gips, në objektin “Shkëmbi i Zekthit”, Bashkia Belsh, Qarku Elbasan që shoqëria Juaj zotëron.

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.805/1, datë 28.03.2005, për mineralin Gips, në objektin “Shkëmbi i Zekthit”, Bashkia Belsh, Qarku Elbasan.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

MINISTRI
BELINDA BALLUKU
ME AUTORIZIM
ZËVENDËSMINISTRI
ILIR BEJTJA

